

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

*Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nr. 1, Tiranë*

*www.klsh.org.al, E-mail: klsh@klsh.org.al*

Nr. 91/7 Prot.

Tiranë, më 28.09.2018

**V E N D I M**

**Nr. 147, Datë 28.09.2018**

**PËR  
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS  
"PERFORMANCA E ISHTI"**

Në zbatim të planit vjetor 2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAT etj.), sipas Programit të auditimit me nr. 91/1 prot., datë 03.04.2018, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ndërmori auditimin me temë "Performanca e ISHTI".

Ekonomia e vendit dhe e gjithë shoqëria shqiptare kanë nevojë për përdorimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore. Konsumatorët shqiptarë janë të mbrojtur me ligj, jo vetëm për të marrë shërbime me cilësi, por në të njëjtën kohë, midis të tjerave kanë të drejtën e mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurisë së jetës si dhe të drejtën e mbrojtjes së interesave ekonomike etj. Inspektimi është një hallkë e rëndësishme e shtetit ligjor për përmirësimin e jetesës së qytetarëve, rritjen e sigurisë së jetës, klimës së biznesit dhe ndërgjegjësimin e subjekteve në zbatimin e rregullave dhe standardeve ligjore të vendosura. Inspektimi do të mund të arrijë efektivitet maksimal nëse kryhet në kushtet e një bashkëpunimi reciprok dhe me përgjegjshmëri midis institucioneve të inspektimit dhe subjekteve që do të inspektohen. Në këndvështrim më të gjerë, funksioni i inspektimit në vendin tonë, bazohet në ligjin e përgjithshëm për inspektimin në Republikën e Shqipërisë. Pikërisht në këtë Ligj në nenin 4, përcaktohet qëllimi i inspektimit dhe në nenin 11, përcaktohet krijimin i inspektorateve shtetërore, ku një prej tyre është edhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për garantimin e cilësisë së naftës dhe nënprodukteve të saj.

Në procesin e inspektimit të karburanteve, marrin pjesë disa subjekte, publike dhe private. Subjektet publike për nga rëndësia e tyre në këtë proces ndahen në dy nivele. Në nivelin e parë janë ato institucione që përfshihen drejtpërdrejtë në inspektim, si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ISHTI, dhe në nivelin e dytë janë ato institucione me të cilat ISHTI bashkëpunon në rastet kur ka nevojë për realizimin e inspektimeve, por që nuk janë të përfshira direkt në këtë funksion, si Dogana, Komisariati Rajonal i Policisë, etj. Në krye të procesit është MIE, si institucioni kryesor përgjegjës për inspektoratin, që harton dhe miraton aktet nënligjore për rregullimin e funksionit të inspektimit (Urdhra, Udhëzime, Rregullore), monitoron

veprimtarinë e ISHTI-t, pajisjen me lejen e tregtisë, ose autorizimin për subjektet që operojnë në fushën e tregtimit, përpunimit dhe transportimit të naftës. Më pas është ISHTI, si institucioni kryesor për zbatimin e akteve nënligjore të nxjerra nga MIE, por jo vetëm, por edhe për kryerjen e inspektimeve për cilësinë e karburantit, pajisjeve dhe instalimeve elektrike dhe atyre nën presion, në subjekte publike dhe private. Në nivelin e fundit të skemës janë subjektet të cilat inspektohen prej ISHTI-t, si rafineritë kompanitë e karburanteve (SHA) dhe pikat e karburantit (SHPK).

Krahas objektivit të përgjithshëm të auditimit të performancës për të evidentuar dhe ndërgjegjësuar nëpërmjet rekomandimeve nëse janë bërë gjërat e duhura në mënyrën dhe kohën e duhur, objektivi specifik ishte që të auditojmë performancën e ISHTI-t si institucion shtetëror, pra u analizua shkalla e realizimit të objektivave të planifikuara, rezultatet e matura kundrejt synimeve dhe atje ku është e mundur edhe burimet e shpenzuara për të arritur këto objektiva, pra *efektiviteti*. Gjithashtu u analizua raporti burime-rezultate i veprimtarisë së inspektimit të tregut të karburanteve, analizave të laboratorit, në të gjithë procese dhe strukturat, pra *eficenca*. Parë në tërësi, rezulton se objektivi i auditimit ishte edhe *ekonomiciteti*, pasi u analizua kostoja e veprimtarisë publike e ISHTI-t, në çdo rast e harmonizuar ngushtë dhe pa cenuar cilësinë e këtij shërbimi. Në këtë auditim u vlerësua dhe MIE, pra nëse aktivitetet e saj, ishin të mjaftueshme për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë së karburanteve për periudhën 01.06.2015-31.12.2017. Qasja e përdorur në këtë auditim, ishte pragmatike, si një miks i qasjes sasiore dhe cilësore. Ky aplikim siguroi një trajtim shterues të performancës institucionale të ISHTI-t në kryerjen e inspektimeve, analizave laboratorike, vendosjen e gjobave dhe nivelin e arkëtimit të tyre si dhe të politikave dhe aktiviteteve të ndërmarra nga MIE. Kjo qasje u përzgjedh në varësi të të dhënave dhe dokumentacionit të grumbulluar.

Në përfundim të punës audituese në terren, iu dërgua Projekt-raporti i Auditimit subjekteve të audituara MIE dhe ISHTI me shkresat përkatëse nr. 92/3 prot., dhe nr. 92/4 datë 24.07.2018. Pas respektimit të afatit për observacione nga palët e interesit, subjektet e audituara, konkretisht: MIE nëpërmjet shkresës nr. 92/6 prot., shpreh vlerësimin rreth këtij materiali, për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre si dhe pati vërejtje apo sugjerime, të cilat janë reflektuar në materialin përfundimtar të auditimit. Gjithashtu ISHTI me shkresën nr. 92/5 prot., është shprehur se është plotësisht dakord me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e lëna në auditim, si dhe puna e kryer nga grupi auditues do të ndihmojë në rritjen e treguesve të performancës në vazhdimësi.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt-vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

## **K O N K L U D O V A :**

Veprimtaria ekonomiko-financiare e ISHTI-t në periudhën 2015-2017 e drejtuar nga Kryeinspektori z. Gazmend Osmani është karakterizuar nga një performancë e lartë, krahasuar me vitet e mëparshme.

Kështu, për këtë periudhë (2015-2017) ISHTI ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh, të cilat janë rritur nga viti në vit: 6641 inspektime për 2015; në vitin 2016 janë kryer 7561 inspektime duke arritur numrin më të lartë 10887 në vitin 2017.

Gjithashtu:

- Mostrat me tregues jashtë standardit kanë ardhur në rënie, konkretisht në vitin 2015 janë 317 mostra në total, në vitin 2016 janë 128, në vitin 2017 janë 44. Gjithashtu numri i mostrave jashtë standardit për naftën vjen në rënie të konsiderueshme sipas viteve 2015-2016-2017, nga 197 - 85 – 23, pra me rreth 80 %.
- Zonat më problematike, të cilat kanë numrin më të lartë të mostrave me tregues jashtë standardit për periudhën Qershor 2015 – Dhjetor 2017 janë Tiranë-Durrës-Elbasan dhe Fier-Vlorë-Berat.
- Ka mungesa në infrastrukturën e nevojshme (makina, karburant, pajisje kompjuterike dhe internet), si dhe të zyrave rajonale, për kryerjen e inspektimeve fizike dhe atyre on-line.
- Ka problematika në organizimin e inspektorëve sipas sektorëve dhe shpërndarjen e formimit profesional të tyre në këta sektor.
- Përgjatë kësaj periudhe janë vendosur gjoba sipas viteve 2015, 2016 dhe 2017 përkatësisht: 271, 257 dhe 76 gjoba, të cilat ndjekin trendin e uljes së subjekteve me tregues të mostrave jashtë standardeve të cilësisë, ku arkëtimi i tyre vjen në rritje, megjithëse ngelet problematik arkëtimi vullnetar i vlerës së gjobave.
- Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm rezulton se: 24 prej rekomandimeve nga 28 në total, janë zbatuar plotësisht, si rrjedhojë punës pozitive të z.Osmani, si dhe pjesa tjetër është në proces zbatimi, sepse kërkohet edhe bashkëpunimi nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Politikat si dhe vendimmarrja e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përgjatë periudhës nën auditim Qershor 2015 - Dhjetor 2017, kanë patur efektivitet të ulët, për shkak se, Ministria ka treguar papërgjegjshmëri në zbatimin e detyrave të saj që burojnë prej dokumenteve strategjike dhe ligjore, gjithë veprimtaria e MIE-s është fokusuar vetëm në plotësimin e kuadrit rregullator, dhe jo në ndërmarrjen e aktiviteteve konkrete për përmirësimin e këtij sektori në bashkëpunim me ISHTI-n, me sektorin privat si dhe në mungesën e monitorimit të veprimtarisë së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial.

- Akoma nuk është kryer një studim mbi rezervat e sigurisë së karburanteve nga MIE, përcaktuar sipas Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2013-2020.
- Nuk janë ushtruar kontrole për sasinë e rezervës së sigurisë në rafineritë, impiantet dhe SHA përgjatë periudhës 01.06.2015-31.12.2017.
- Një pjesë e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit të Naftës kanë dalë me vonesa.
- Ka patur mungesë monitorimi dhe mbikqyrje nga Ministria ndaj ISHTI-t.
- Vazhdon të ngelet problematike mos përcaktimi si detyrim ligjor se si duhet të veprohet me karburantin kur ai rezulton jashtë standardit.

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, jemi përpjekur t'i japim përgjigje pyetjes kryesore:

*A kanë performuar mjaftueshëm institucionet përgjegjëse në garantimin e cilësisë së karburanteve përgjatë periudhës 01.06.2015-31.12.2017? dhe në përfundim u arrit në këtë mesazh auditimi:*

**Kontrolli i Lartë i Shtetit konstaton se ka progres të moderuar në garantimin e cilësisë së karburanteve për periudhën 01.06.2015 - 31.12.2017, i cili mund të ishte më i lartë nëse Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të ishte mjaftueshëm efektive në këtë**

**fushë, si dhe ISHTI nuk do të kishte mangësi në plotësimin e logjistikës së nevojshme për të realizuar aktivitetet e planifikuara.**

Nisur nga konkluzionet mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve në këtë sektor:

## **V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Performanca e ISHTI”, të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe në Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

### **I. Për pyetjen 3.1: A ka qenë efektiv MIE në rritjen e cilësisë së karburanteve?**

- Politikat si dhe vendimmarrja në të gjitha drejtimet e mësipërme të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përgjatë periudhës nën auditim 2015-2017, kanë patur efektivitet të ulët, për shkak se, Ministria ka treguar papërgjegjshmëri në zbatimin e detyrave të saj që burojnë prej dokumenteve Strategjike dhe Ligjor, gjithë veprimtaria e MIE-s është fokusuar vetëm në plotësimin e kuadrit rregullator, dhe jo në ndërmarrjen e aktiviteteve konkrete për përmirësimin e këtij sektori në bashkëpunim me ISHTI-n, me sektorin privat si dhe në mungesën e monitorimit të veprimtarisë së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me qëllimin kryesor rritjen e cilësisë së karburanteve.

### **II. Për pyetjen 3.1.1: A ka ndërmarrë MIE aktivitetet e duhura për rritjen e cilësisë së karburanteve?**

- Mungesa e një studimi mbi rezervat e sigurisë së karburanteve, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (ish Ministria e Energjisë dhe Industrisë), përcaktuar sipas SKE 2013-2020, për të cilin, kryerja dhe arritja në konkluzione, ka shumë rëndësi për organizimin dhe funksionimin e këtij sektori, tregon papërgjegjshmëri të MIE për këtë sektor, si dhe gjatë gjithë kësaj periudhe 2013 – 2018 siguria dhe mbrojtja e konsumatorëve nga rreziku i ndërprerjes së furnizimit me energji e vendit si dhe rritje të ndjeshme dhe të menjëhershme të çmimit të karburantit ka qenë e cenuar dhe asnjëherë e garantuar.

- Raportimi në MIE vetëm nga SHA dhe jo edhe nga rafineritë, impiantet e përpunimit siç e kërkon Ligji i Naftës, gjatë periudhës 2015-2017, si dhe raportimi jo i plotë mbi ecurinë e aktivitetit të tyre në asnjë prej viteve 2015-2016-2017 (pra sa sasi kanë blerë, prodhim vendas apo import, sa kanë shitur, sa sasi kanë në dispozicion në fund të vitit, etj), por vetëm se sa kanë shitur dhe moszbatimi i penaliteteve që përcaktohen Ligjin e mësipërm për këto mosveprime, tregon për një punë të dobët të MIE-s, raportime me shifra jo të sakta të Ministrisë në Qeveri për rezervën e karburanteve, mungesë bashkëpunimi midis sektorit publik dhe privat si dhe rritjen e mundësisë së ndikimit negativ në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, por edhe në rregullimin e konkurrencës së tregut.

- Mungesa e një dokumenti në të cilin të pasqyrohet informacioni mbi punën e kryer për rezervën e sigurisë së karburanteve, në arritjen e konkluzioneve si dhe në masat që duhet të merren për përmirësimin e situatës nga grupi ndërinstucional ngritur me Urdhër të Kryeministrit në vitin 2013, pjesë e të cilit është edhe MIE, mund të ndikojë negativisht në mirëfunksionimin e këtij sektori si dhe zhvillimin normal të tregut të karburanteve.

*Për këto rekomandojmë:*

1. MIE, si një vend anëtar i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, të marrë masat e nevojshme që të kryejë studimin sipas përcaktimit të SKE 2013-2020 mbi rezervat e karburanteve, ku të krijojë dhe të përshkruajë në mënyrë të detajuar bilancin e hidrokarbureve në tregun vendas (sasia në fillim të vitit, sasia e importuar, sasia e prodhuar në vend, ajo e eksportuar), të nxjerrë konkluzione të qarta dhe specifike se ku janë pikat e dobëta dhe të forta si dhe të marrë masat e nevojshme në përputhje me konkluzionet e arritura, me qëllimin final stabilitetin e tregut të karburanteve dhe sipas gjykimit të grupit të auditimit, arritjen në evidentimin më shpejtë të burimit se prej nga mund të dali karburanti me rezultate jashtë standardit për mbrojtjen e konsumatorit.

**Brenda vitit 2018**

2. MIE si anëtare e grupit ndërinstitucional të ngritur me Urdhër të Kryeministrit në vitin 2013, të marrë masat e nevojshme, të njoftojë Qeverinë se në çfarë faze të punës ndodhet ky grup, si dhe të bashkëpunojë me anëtarët e tjerë për përfundimin e materialit mbi rezervën e sigurisë së karburanteve.

**Brenda vitit 2018**

- Mungesa e informacionit nga ana e MIE për grupin e auditimit mbi kontrollet e ushtruara apo jo në subjektet që operojnë në sektorin e karburanteve (146 SHA, 4 rafineri dhe 4 impiante përpunimi), krijon bindjen e arsyeshme, se nuk janë ushtruar kontrolle të tilla përgjatë periudhës 01.06.2015-31.12.2017, ku me shumë mundësi sipas gjykimit të grupit të auditimit, do të ishte reduktuar edhe madhësia e dëmit të shkaktuar nga falimentimi para pak muajsh, i njëjës prej kompanive më të mëdha në tregtimin e karburanteve në vendin tonë, ku rezultoi se depozitat e saj nuk kishin asnjë litër naftë, si dhe me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit.

*Për këtë rekomandojmë:*

3. MIE të marrë masat e nevojshme që të hartojë një databasë me informacion të saktë dhe të plotë për të gjithë subjektet mbi ecurinë e aktivitetit të tyre, kontrollet e ushtruara, masat e mara, etj., (SHA; Rafineri dhe Impiante Përpunimi), që operojnë në këtë sektor si dhe të ushtrojë kontrollet sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin e Naftës, të ndryshuar.

**Brenda 3-mujorit të katërt të vitit 2018 për databasën dhe Vazhdimisht për kontrollet**

- Mos përcaktimi konkret dhe i saktë i detyrimeve ligjore se si duhet të veprohet me karburantin që ka tregues jashtë standardit, në Ligjin e Naftës dhe Udhëzimin e përbashkët midis MF-së, MZHE'TTS, MIE dhe MPB "Për kontrollin cilësor, sasior dhe fiskal të naftës dhe nënprodukteve të saj", rrit mundësitë për ekzistencën në treg të naftës me tregues jashtë standardit, shton kostot financiare të konsumatorit në riparimin dhe mirëmbajtjen e makinës dhe pajisjeve të tjera si dhe ndikon negativisht në shëndetin e tij si pasojë e ndotjes së mjedisit nga karburanti jo cilësor.

*Për këtë rekomandojmë:*

4. MIE të marrë masat e nevojshme që në Ligjin e Naftës të përcaktojë se si duhet të veprohet me karburantin, kur nga kontrollet e ushtruara rezulton se ka tregues jashtë standardit. Këtë përcaktim ta pasqyrojë në çdo akt nënligjor që del në zbatim të këtij Ligji. Gjithashtu në Udhëzimin e mësipërm, në rastin e prodhimit vendas, importit tokësor dhe në tregtimin me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, të përcaktohet edhe kryerja e kontrollit sasior për naftën dhe nënproduktet e saj.

**Brenda vitit 2018**

- Mos plotësimi në kohë me akte nënligjore i Ligjit të naftës, me vonesa 2 muaj deri në 1 vit, si dhe nxjerrja rreth 4 muaj me vonesë e Urdhrit të Ministrit për përcaktimin e tarifave dhe afateve të kontrolleve periodike në subjektet e këtij sektori, kohë e gjatë në krahasim me dinamikën e këtij sektori, ka ndikuar negativisht në efektivitetin e inspektimeve të ISHTI-t për periudhën Shtator 2015 – Janar 2016.

*Për këtë rekomandojmë:*

5. MIE të tregohet më e përgjegjshme në ndërmarrjen e veprimeve nga ana e saj, konkretisht në plotësimin brenda afateve të kërkuara të kuadrit rregullator për këtë sektor, në momentin kur sipas ligjit i lind një detyrim i tillë. Gjithashtu MIE të marrë masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së re institucionale, duke pasqyruar të gjitha ndryshimet në rristurimin e saj të bërë në vitin 2017.

**Brenda 3-mujorit të katërt të vitit 2018 për Rregulloren dhe Vazhdimisht për bazën ligjore në tërësi.**

- Zhvillimi i politik-bërjes nga ana e Ministrisë për ISHTI-n, vetëm në sferën e plotësimit dhe përafrimit të kuadrit rregullator me atë BE-së, mungesa e përcaktimit të objektivave afatmesëm, vjetor dhe treguesve specifik të Inspektoratit, tregon për dobësi në zbatimin e detyrimeve ligjore nga institucioni epror, mungesë monitorimi dhe mbikqyrje nga MIE ndaj ISHTI-t, e cila mund të ndikojë në mënyrë direkte në uljen efektivitetit të inspektimit të cilësisë së karburanteve.
- Mungesa e aktiviteteve të Ministrisë përgjatë periudhës 2015-2017, për ndërgjegjësimin e subjekteve që operojnë në këtë sektor, si dhe mungesa e bashkëpunimit midis Drejtorisë së Hidrokarbureve në Ministri me ISHTI-n, gjatë kësaj periudhe, për zhvillimin e këtij tregu, me standarde teknike e cilësore në nivelin e vendeve evropiane, tregon bashkëpunim të dobët midis institucioneve publike me njëra-tjetrën që mbikqyrin cilësinë e karburanteve si dhe midis këtyre me sektorin privat, duke rritur ndikimin negativ në përditësimin dhe plotësimin e saktë të standardeve në këtë sektor dhe në cilësinë e karburanteve që tregtohen në vendin tonë.

Për këtë rekomandojmë:

6. MIE në kuadër të politik-bërjes në këtë sektor, ta zhvillojë atë jo vetëm në plotësimin e kuadrit rregullator, por të rrisë nivelin e bashkëpunimit me ISHTI-n për çdo problematik të evidentuar, të ndihmojë në forcimin e kapaciteteve inspektuese me trajnime, shkëmbime eksperiencash me vendet e BE-së, të garantojë fondet për investime në pajisjet laboratorike.

7. Gjithashtu MIE, të kryejë aktivitete në bashkëpunim me ISHTI-n dhe operatorët privat, të cilat duhet të konsistojnë në rregullat ligjore dhe standardet që duhet të respektohen prej subjekteve, cilësinë e karburanteve që tregtojnë, transparencën e tyre në lidhje me çmimet, reklamimin e llojit të karburantit që tregtojnë (vendas apo importi), etj., me qëllim zhvillimin me ritme të qëndrueshme të këtij tregu, përafrimin në çdo drejtim me vendet e BE-së si dhe garantimin cilësisë së produkteve që përdoren nga konsumatorët.

8. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet, duhet të raportojë në Komisionet përkatëse të Parlamentit, minimalisht një herë në vit, mbi ecurinë e aktivitetit të saj. Kësaj çështje t'i jepet zgjidhje nga MIE në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë.

**Vazhdimisht**

**III. Për pyetjen 3.1.2: A ka zbatuar MIE rekomandimet e auditimit të mëparshëm të performancës realizuar nga KLSH në Dhjetor 2015?**

Nga bashkëbisedimi realizuar midis grupit të auditimit dhe stafit përgjegjës në MIE për këtë sektor si dhe shqyrtimit të dokumentacionit vënë në dispozicion rezulton se: për 4 rekomandimet e auditimit të mëparshëm të performancës, për realizimin e të cilëve kërkohej bashkëpunimi i Ministrisë, nuk është marrë asnjë masë nga Ministria përgjegjëse, por edhe nga Inspektorati, konkretisht:

- Rregullorja e brendshme e ISHTI-t është dërguar në fund të vitit 2015 për miratim në Ministri, dhe nga kjo e fundit nuk ka asnjë vendimmarrje;
- Në lidhje me strategjinë afat-mesme për uljen e numrit të pikave të karburantit, me qëllim mbulim sa më të mirë të tyre me inspektime, rezulton se ISHTI nuk e ka përgatitur;
- Për përmirësimin e Ligjit të Naftës, si kriteret e emërimit dhe të largimit nga puna të Kryeinspektorit, ISHTI ka dërguar sugjerimet e veta në Ministri, por nuk ka marrë përgjigje;

*Për këto rekomandojmë:*

9. Në funksion të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, ku përfshihet edhe Ministria, si dhe në përputhje me konkluzionet dhe rekomandimet e këtij auditimi që po zhvillohet aktualisht, ku këto rekomandime jepen përsëri, të merren masat e nevojshme nga të dyja Institucionet (MIE dhe ISHTI) për realizimin e tyre.

**Brenda 3-mujorit të katërt të vitit 2018**

#### **IV. Për pyetjen 3.2.1.1: A i ka shërbyer laboratorit i ISHTI-it rritjes së cilësisë së karburanteve?**

- Me gjithë rritjen e numrit të mostrave gjithsej në periudhën 2015-2017, vërehet se krahas prirjes së përgjithshme për rënien e mostrave dhe treguesve jashtë standardit në periudhën 2015-2017, kjo gjë nuk ndodh për standardin e përmbajtjes së squfurit më pak se 1 % tek lëndët djegëse, përmbajtjes së squfurit në gazoil dhe benzinë mbi pesëfishin, për pikën e flakërimit midis 4° dhe 7° si dhe të squfurit tek lëndët djegëse mbi 3-fishin e normës së lejuar.

- Gjithashtu nga luhajtjet e përmbajtjes së squfurit prej 1 % e lart në vitin 2015, i cili rezultonte në 6.3 % të totalit të analizave jashtë standardit, pothuajse trefishohet në 2016 dhe është treguesi më i lartë në 2017, i cili përfaqëson 45.5 % të mostrave me tregues jashtë standardit, që mund të tregoj për një mos-orientim të mirë të punës midis DING dhe DLQK.

*Për këtë rekomandojmë:*

10. ISHTI të përqendrojë aktivitetin e tij për mostër-marrjen rastësore në subjektet që konsumojnë lëndë djegëse, duke marrë masa të ashpra ndëshkuese ndaj atyre me tregues jashtë standardit deri në mbylljen e tyre. Gjithashtu DLQK duhet të bashkëpunojë me drejtorinë e tjera për të analizuar shkaqet e prirjes së këtij treguesi, dhe për ta përqendruar vëmendjen në inspektimin dhe mostër-marrjen-në ato subjekte që i përkasin kësaj kategorie të përdorimit të naftës dhe nënprodukteve të saj.

**Vazhdimisht**

- Përmirësimet e dukshme të cilësisë së Dizelit dhe Benzinës përgjatë periudhës 2015-2017, pasi rezultojnë gjithnjë e më pak mostra jashtë standardit, tregon se nga DING dhe DLQK është bërë një punë e mirë në këtë drejtim, duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e karburanteve të mësipërm, por kjo gjë nuk ndodh për të tjerat (lubrifikantë, naftë brut etj.), rezultatet e të cilave kanë luhajtje nga viti 2015 deri në vitin 2017.

*Për këtë rekomandojmë:*

11. ISHTI duhet të kryejë një analizë të mirë-detajuar, përse ndodh kejo dukuri, me qëllim thellimin dhe përqendrimin në atë segment të subjekteve që operojnë dhe shkaktojnë këtë përkeqësim të prirjes së përmirësimit të cilësisë së karburanteve në tërësi, kryesisht për lubrifikantët dhe naftën brut.

**Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2018 dhe Vazhdimisht**

- Mospërputhjet e evidentuara nga grupi i auditimit në raportet e ndryshme të drejtorive për disa tregues të aktivitetit si nga viti në vit për ato që janë të krahasueshëm, si numri i mostrave të marra gjithsej; numri i mostrave të detyrueshme dhe atyre për sondazh, mostra nga importet etj, mund të ndikojë negativisht në pasqyrimin e saktë të situatës së këtij sektori, në raportet që mund të kërkohen nga institucioni epror ose dhe palë të tjera të interesuara.

*Për këtë rekomandojmë:*

12. Drejtorinë e Inspektoratit të tregobën të kujdesshme në pasqyrimin e saktë të informacionit të aktivitetit të tyre, në raportimet mujore dhe ato vjetore, me qëllim që edhe nëse do të ketë nevojë për marrjen e masave, këto të fundit të jenë sa më afër realitetit.

**Vazhdimisht**

- Luhatjet e konsiderueshme të mostrave të analizuara nga Laboratori midis muajve të ndryshëm gjatë periudhës 2015-2017, tregojnë për një mungesë analize dhe bashkërendimi të mirë të punës midis drejtorive për marrjen dhe analizën e mostrave, që mund të ndikojnë negativisht në regjistrimin e saktë të rezultateve të analizave.

*Për këtë rekomandojmë:*

13. *Të dy drejtoritë të cilat janë përgjegjëse për cilësinë e karburanteve, të kryejnë një analizë të detajuar, për të bashkërenduar sa më mirë aktivitetin e tyre, duke patur një ecuri konstante si në marrjen e mostrave edhe në testimin e tyre si dhe për të rritur besueshmërinë e analizave.*

**Vazhdimisht**

- Qëndrueshmëria e stafit të DLQK si dhe formimi profesional në përputhje të plotë me aktivitetin që kryhen kjo drejtori përgjatë periudhës 01.06.2015 - 31.12.2017, ka ndikuar pozitivisht në mbarëvajtjen e punës së kësaj drejtorie si dhe në rritjen e besueshmërisë së mostrave të analizuara. Problematikë sipas gjykimit të grupit të auditimit mbeten trajnimet, të cilat janë të pakta në krahasim me Drejtoritë e tjera të ISHTI-t si edhe me zhvillimet e shpejta në këtë sektor (shtimi dhe ndryshimet e standardeve, zhvillimet teknologjike, etj).

*Për këtë rekomandojmë:*

14. *ISHTI t'i kushtojë më tepër vëmendje trajnimit të stafit të Laboratorit, me qëllim forcimin e njohurive të tyre, reduktimin e diferencave midis drejtorive, duke ndikuar në këtë mënyrë në performancën e stafit si dhe në rritjen e mëtejshme të besueshmërisë së analizave.*

**Vazhdimisht**

- Defektet e shkaktuara në disa prej pajisjeve të ndryshme të laboratorit (rreth 5 prej tyre nga 32 në total) përgjatë periudhës 2015-2017, kanë patur ndikim negativ në aktivitetin e tij, duke sjellë edhe pengesa për disa ditë me radhë në punën e përditshme të laboranteve, moskryerjen e analizave dhe mos deklarimin e rezultateve për treguesit përkatës, ku vlen të theksohet defekti i aparatit të matjes së squfurit në vlera të ulëta. Veç këtyre, konstatohet mungesa e investimeve drejtim të dixhitalizimit të të dhënave të analizave laboratorike të naftës dhe nënprodukteve të saj si dhe në infrastrukturën e ndërtimit ku mungesa e ventilimit të laboratorit është problematike, gjë që rrezikon dëmtimin e mostrave referuese.

*Për këtë rekomandojmë:*

15. *ISHTI të marrë masat e nevojshme për të rregulluar defektet e pajisjeve të laboratorit, çdo pajisje e tij të jetë e dubluar, me qëllim që në momentin kur ka defekt një aparaturë, të vihet në përdorim tjetra, për të mos penguar aktivitetin si dhe të kryejë investimet e duhura për dixhitalizimin e të dhënave laboratorike, si dhe për përmirësimin e infrastrukturës, konkretisht ventilimin e laboratorit.*

**Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2018**

- Kryerja jo e balancuar e analizave ndaj numrit të treguesve për mostrat e detyrueshme dhe të sondazheve, (gazoil mostra të detyrueshme 17 tregues, sondazhet 8 tregues; si dhe për benzinën 11 tregues për kampionet e detyrueshme dhe 9 tregues për sondazhet), sipas gjykimit të grupit të auditimit mund të ndikojë negativisht në besueshmërinë e analizave.

*Për këtë rekomandojmë:*

16. *Me qëllim përforcimin e besueshmërisë së analizave, ISHTI duhet të sigurojë mbulimin e plotë duke testuar të gjithë treguesit si për mostrat e detyrueshme edhe për sondazhet.*

**Vazhdimisht**

- Përfundimi i marrëveshjes kuadër “Shërbim inspektimi e mirëmbajtje preventive, riparim dhe kalibrim të pajisjeve të laboratorit të naftës dhe të gazit” në Dhjetor të vitit 2017 e vë në



vështirësi laboratorin për reagentë, mostrat referuese, kolaudimin dhe riparimin e pajisjeve që pësojnë defekte.

*Për këtë rekomandojmë:*

17. ISHTI të marrë masat e nevojshme (lidhjen e marrëveshjes ose sigurimin e financimeve) që të disponojë gjithë bazën materiale (reagentë, mostrat referuese, kolaudimin dhe riparimin e pajisjeve që pësojnë defekte) për funksionimin e plotë dhe në nivelin e duhur të Laboratorit.

**Brenda tre mujorit të tretë të vitit 2018**

**V. Për pyetjen 3.2.1.2: A disponon ISHTI logjistikën e nevojshme për të realizuar aktivitetet e planifikuara?**

- Rritja e numrit të inspektimeve, si në mostër-marrje të detyrueshme dhe në sondazhe, përgjatë periudhës 01.06.2015-31.12.2017, trajnimi, qëndrueshmëria e stafit të DING dhe plotësimi i vendeve vakante në kohë të shkurtër, ka ndikuar pozitivisht rritjen e performancës së kësaj drejtorie, në uljen e mostrave me tregues jashtë standardit (nafta, benzina dhe lëndë të tjera djegëse) duke sjellë përmirësimin e cilësisë së karburanteve në tërësi në tregun Shqiptar.

- Ekzistenca në pjesën më të madhe të profesioneve që nuk lidhen me aktivitetin e DING, shpërndarja jo e drejtë këtyre profesioneve si dhe organizimi jo i duhur i numrit të inspektorëve sipas sektorëve, ka krijuar disbalanca në punën e inspektorëve, duke e vënë në vështirësi atë.

*Për këtë rekomandojmë:*

18. ISHTI, me qëllim organizimin e duhur të inspektorëve, ndarjen e drejtë të ngarkesës në punë si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të inspektimeve, të kryejë një analizë të detajuar për organizimin e burimeve njerëzore në DING si dhe të vazhdojë të kryejë trajnime për inspektorët e këtij sektori.

**Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2018**

19. DING duhet të fokusojë më shumë punën e tij inspektuese në kontrollin cilësor të lëndëve të tjera djegëse si dhe në zonat në të cilat, nga kontrollet e ushtruara rezultojnë më shumë mostra jashtë standardit në krahasim me zonat e tjera.

**Vazhdimisht**

- Mungesa e infrastrukturës së nevojshme (makina, karburant, pajisje kompjuterike dhe internet), si dhe zyrave rajonale, ka penguar në realizimin në nivele të larta të aktivitetit të inspektimit të DING, kryesisht në inspektimet on-line përgjatë periudhës 2015-2017 (kosto financiare dhe kosto në kohë).

*Për këtë rekomandojmë:*

20. ISHTI të marrë masat e nevojshme në bashkëpunim edhe me MIE, për të siguruar infrastrukturën që përmendet më sipër, ku të paktën një sektor të ketë një makinë si dhe pjesën tjetër të logjistikës për një ecuri normale të aktivitetit dhe garantimin e pavarësisë së inspektorit ndaj subjektit privat.

**Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2018**

- Luhatjet e numrit të inspektimeve të DING për dokumentacionin tekniko-ligjor, mund të ndikojë negativisht duke krijuar hapësira për subjektet e këtij sektori që të neglizhojnë në këtë drejtim, çka pasojat finale do të kishte në mungesën e konkurrencës së ndershme në treg dhe abuzimin me cilësinë e karburanteve.

*Për këtë rekomandojmë:*

21. ISHTI, por kryesisht DING të vazhdojë me të njëjtat ritme që ndjek në kontrollin e cilësisë edhe për kontrollin e dokumentacionit tekniko-ligjor, me qëllim shmangien e dukurive të mësipërme.

**Vazhdimisht**

- Mungesa e një manuali të detajuar për kryerjen e inspektimeve nga ISHTI, ku do të sillte një unifikim dhe përforsim të punës së inspektorëve, ka patur ndikimin e vet negativ letrat e punës së inspektorëve, si p.sh në mungesën në disa raste të autorizimit të titullarit të institucionit për inspektim dhe marrje mostrash; pasaktësi në dhënien e informacionit për rezultatet e analizave, mungesën e njoftimit të subjektit para se të shkojë për inspektim, etj.

*Për këtë rekomandojmë:*

22. *ISHTI të marri masat e nevojshme për përgatitjen e një manuali të detajuar për procesin e inspektimeve, ku ti referohet edhe detajimit të përmbajtjes që duhet të ketë ai, që ka bërë grupi i auditimit gjatë shtjellimit të kësaj çështje.*

***Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2018***

#### **VI. Për pyetjen 3.2.1.3: A janë efektive penaltetet e vendosura nga ISHTI?**

- Respektimi i ligjit nga inspektorët, objektiviteti në vendosjen e gjobave, operativiteti në vjeljen e tyre si dhe rritja e arkëtimit të tyre, veçanërisht në mënyrë vullnetare, ka ndikuar pozitivisht në rritjen e efektivitetit të penalizimeve, rritjen e ndërgjegjësimit të subjekteve, e cila përkthehet në përmirësim të cilësisë së karburanteve. Problematike ngelet, që një pjesë e konsiderueshme e vendimeve të ISHTI-t, rrëzohen në gjykatë, ku një ndër shkaqet kryesore është, se në momentin kur shkohet për inspektim, subjekti nuk njoftohet paraprakisht, e cila shpesh herë sjellë pasoja në vendimmarrje të gabuar.

*Për këtë rekomandojmë:*

23. *ISHTI të tregojë kujdes në momentin që vendos për kryerjen e inspektimit në subjekt, duke e njoftuar atë në përputhje me afatin që përcaktohet në ligj, duke bërë në këtë mënyrë që çdo vendim për penalizim të jetë më i qëndrueshëm dhe më efektiv.*

***Vazhdimisht***

#### **VII. Për pyetjen 3.2.2: A ka zbatuar ISHTI rekomandimet e auditimit të mëparshëm të performancës realizuar nga KLSH në Dhjetor 2015?**

- Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të performancës në drejtim të ISHTI-t, si dhe nga analizat e kryera nga grupi auditimit, përpunimet statistikore, për të vërtetuar më mirë zbatimin e rekomandimeve, kanë sjellë ndikimin e tyre në rritjen e performancës institucionale të Inspektoratit, gjatë drejtimit nga z. Gazmend Osmani, veçanërisht në inspektimet, mostër-marrjet, aplikimin e penalteteve. Problematike ngelet pjesa e rekomandimeve ende të pa zbatuara prej Inspektoratit, ku me rëndësi të veçantë është mos miratimi i rregullores së brendshme institucionale së tij.

*Për këtë rekomandojmë:*

24. *ISHTI të marri masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i performancës, të cilat ende nuk janë realizuar.*

***Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2018***

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**